



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**BORDI  
VENDIM**

**Nr. 27, Datë 28.02.2019**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“SANG 1” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC “THIRRË” ME FUQI TË INSTALUAR 1820 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie.

**Konstatoi se:**

Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. me shkresën nr. 124 Prot., datë 06.02.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thirrë” me fuqi të instaluar 1820 KW.

Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “f”, ) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “d”; 4.1.4 gërmat “b”, “c”, “d”, “e”; 4.1.5 gërma “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kohëzgjatja e kontratës nr. 2753 Rep; nr. 1403/2 Kol, datë 12.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Thirrë” me kapacitet prodhues 1.820 MW, në përroin e Thirrës dhe në degët formuese të tij, ai i Kumbllës, Runjës dhe Qarrit degë e lumit Fani i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë” do të jetë 49 vjetë nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

Neni 38 i Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcakton se: ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të aplikuesit që ka të bëjë me :

- Nenin 9, pika 4.1.3, gërma “b”, “c”; Nenin 9, pika 4.1.4 gërma “a” (Studimi i fizibilitetit) dhe nenin 9, pika 4.1.5, gërma “a” dhe “b” (Miratimi i pikës së lidhjes) dhe (Leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thirrë” me fuqi të instaluar 1820 KW për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARE E BORDIT**  
**ERJOLA SADUSHI**